



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJORË MAT

Vendim

Nr. 43 Date 22/09/ 2017

Për

Dhënien e mendimit për përdorim të rezervës ujore për energji elektrike për HEC “Malthi” nga subjekti “Besjana” shpk, Përroi i Ljusës degë e Lumit Mat në Bashkinë Mat, Qarku Dibër.

- Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore”, nenit 24 të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015, “Per miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”(i ndryshuar), me propozim të A.B.U. Mat, **Këshilli i Basenit Ujor Mat,**

Vendosi:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “Besjana” shpk me Administrator Z.Shefki Doma, për “Përdorim Rezerva Ujore për Energji Elektrike” sipas studimit të paraqitur nga subjekti “Besjana” shpk, me këto të dhëna:

H/C “Malthi”

Subjektit juridik/fizik: “ Besjana ” shpk

- Përroi të Ljusës degë e lumit Mat me vendodhje në Bashkinë Mat, Qarku Dibër.
- Prurja mesatare 2.97 m3/sek
- Prurja llogaritese 3.4m³/sek
- Prurja ekologjike 0.3m³/sek.
- Kuota e Vepra e marrjes: **Z- 248m.n.d** **X – 44 22 835** **Y- 46 07 397**
- Kuota e godines se HEC-i: **Z- 162 m.n.d** **X – 44 18 942** **Y- 46 07 155**
- Fuqia e instaluar : 1960KW ,ore pune/vit 4147
- Kapaciteti prodhues mesatar: 8 130 874 Kwh/vit

2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes,i furnizimit me ujë të popullatës etjere nga përdorimi i ujit për energji elektrike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT
Ast NIKOLLA



KRYETARI I K.B.U. MAT
Eduard NDRECA

